

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KORÇË

YJ-A-Pirg
STIMP
dt 09.04.2024
[Signature]

Nr. Akti 946/1506

Datë 27.03.2024.

“Njoftim me shpallje publike”

Drejtuar: Njesia Administrative Pirg, Bashkia Maliq.

Per te padituren: Elvira Sotiri (Malo), banuese ne fshatin Sovjan, Njesia Administrative Pirg, Bashkia Maliq.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me trup gjykues të përbërë nga **Gjyqtar Seladin Pysqyli**, asistuar nga sekretare Eriselda Elmazaj, në gjykatë, sot më datë **27.03.2024**, përfundoi gjykimin e çështjes civile me **nr.vendimi 317**, me palë dhe objekt:

PADITES: Andi Sotiri

E PADITUR: Elvira Sotiri (Malo)

Me objekt: -Zgjidhje martesë ligjore etj.

Baza ligjore: Neni 129 e vijues i K.Familjes.

Gjykata, pasi shqyrtoi rrethanat e çështjes e cmoi ne teresi provat shkresore,

VENDOSI:

1-Zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur më datë 12.07.2016 midis paditësit Andi Sotiri dhe të paditurës Elvira Sotiri.

2-Me zgjidhjen e martesës e paditura Elvira merr mbiemrin paramartesor, nga Sotiri në Malo.

3-Fëmija Aenda Sotiri e datëlindjes 29.07.2019 i lihet për rritje dhe edukim babait, paditësit Andi Sotiri.

4-E paditura Elvira ka të drejtë të takojë dhe mbajë fëmijën Aenda Sotiri gjatë periudhave kohore si vijon: Fundjavën e parë dhe të tretë të çdo muaji, prej orës 10:00 deri në orën 14:00 të ditës së shtunë; gjatë pushimeve verore prej orës 10:00 të datës 01 Gusht deri në orën 16:00 të datës 07 Gusht të çdo viti; gjatë pushimeve dimërore nga data 01 Janar ora 10:00 deri në datën 03 Janar ora 16:00 të çdo viti; në ditën kur fëmija ka ditëlindjen dhe në ditë feste e gëzime familjare për një kohe prej 2-3 orë mbasdite; si dhe të komunikojë me fëmijën në mënyrë audio-vizive dy herë në javë, ditën e hënë dhe të enjte, gjatë intervalit kohor prej orës 16:00 deri në orën 18:00.

5-Detyrimin e të paditurës Elvira të japë kontribut ushqimor për vajzën Aenda Sotiri në vlerën 10,000 (dhjetë mijë) lekë në muaj, detyrim që fillon nga dita e ngritjes së padisë, datë 28.09.2023.

6-Detyrimin e të paditurës Elvira të paguajë në favor të paditësit Andi Sotiri shumën 21,500 (njëzet e një mijë e pesëqind) lekë, e cila përfaqson ½ e vlerës së shpenzimeve gjyqësore të kryera nga paditësi.

7-Urdhërohet sekretaria e gjykatës që, pasi vendimi të marrë formë të prerë, ti dërgojë një kopje të tij Z.Gj.Civile Korçë për të bërë ndryshimet në regjistër.

8-Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe me ekzekutimin e tij ngarkohet shërbimi përmbarimor gjyqësor, shtetëror ose privat, sipas kërkesës të palës kreditore.


9-Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

-U shpall në Korçë, sot më datë 27.03.2024.

SEKRETARE

Eriselda ELMAZAJ

[Signature]



Kjo shpallje do të qëndroje e afishuar në vendet e mësipërme minimalisht 20 (njëzet ditë) nga momenti i afishimit.

Shpallja do të dërgohet në dy kopje, njëra prej të cilave duhet të përcillet në gjykatë, menjëherë pas afishimit.

Shpallja u afishua sot në datë _____

Njesia Administrative _____

Punonjesi i gjykatës _____

Nr. 78 Prot
Dt. 11.04.2024